



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR

Gjirokastrë, më 09/05/2025



✚ “DITA KOMBËTARE E DREJTËSISË”

✚ Në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, Zv/Kryetarja e Gjykatës Znj. Entela Selmanaj, organizoi një takim me fokus sigurimin e aksesit në drejtësi veçanërisht për kategoritë në nevojë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ligjore të garantuara nga shteti.

✓ Pjesëmarrës në takim ishin Gjyqtarja e Medias znj. Orinda Lloshi, Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatëve z. Arjan Sotiri, Drejtoresha e Shërbimit Social Gjirokastrë znj. Magdalena Margariti, Drejtoresha e Agjencisë së Shërbimit Social e Shëndetësor znj. Melpomeni Manxhari, Përgjegjësi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Gjirokastrë, z. Florjan Berberi, si dhe përfaqësueset e Qendrës së Dhënies së Ndihmës Juridike Falas, në Gjirokastrë dhe Përmet, Znj. Klaudia Veizi dhe znj. Fetie Maliqi.

✓ Gjatë fjalës së saj, Zv/Kryetarja znj. Selmanaj u shpreh: “Në kuadër të Javës së Drejtësisë, që kulmon në datën 10 maj, datë e cila mbart një simbolikë të veçantë për shoqërinë shqiptare organizova këtë takim për të vënë në dukje rëndësinë e aksesit në drejtësi të shtresave të marginalizuara dhe atyre që gjenden në kushte të veçanta ekonomike, shoqërore e shëndetësore.

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format që mundëson aksesin në drejtësi dhe që çdo shtet duhet të garantojë, pasi aksesin në drejtësi është e drejtë themelore kushtetuese”.

✓ Sipas znj. Selmanaj, administrimi i mirë i drejtësisë fillon së pari me garancitë që duhet të ketë çdo individ për realizmin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij, ligjore dhe kushtetuese.

✓ Të pranishmit në takim vlerësuan menaxhimin dhe administrimin e bërë deri tani nga gjykata, që pavarësisht ngarkesës së punës ka dhënë zgjidhje në mënyrë të shpejtë, për çështje të ndjeshme për komunitetin.

✓ Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër duke vlerësuar të gjithë bashkëpunimin e deritanishëm shpreh gatishmërinë maksimale për të intensifikuar bashkëpunime të mëtejshme që i shërbejnë rritjes së cilësisë së shërbimeve ligjore.

